

MAURO BIGLINO

**NUK KA
“KRIJIM”
TEK BIBLA**

**(UNGJILLI NA TREGON TJETËR
HISTORI)**

TIRANË MAJ 2015

Përktheu nga italishtja	Skënder Romina	Hushi Hushi
Nxorri materialet nga kompjuteri dhe sistemoi librin	Erin	Hushi
Ndreqi gabimet e piksimit	Ramazan	Hushi
Dhuroi kopertinën e fundit	Bashkim	Klloboçishta

Tipografia----**Emal**

ISBN -----978-9928-04-270-5

E drejta e botimit dhe e ribotimit të këtij libri i takon vetëm përkthyesve me miratimin e autorit Mauro Biglino.

MAURO BIGLINO

**NON C'È
CREAZIONE
NELLA BIBBIA**

**LA GENESI CI RACCONTA
UN'ALTRA STORIA**

una ricerca per liberi pensatori



**NON C'È CREAZIONE NELLA
BIBBIA**
LA GENESI CI RACCONTA UN'ALTRA STORIA

Treguesi

Faqe	Emërtimi
.	.
. 6	-Hyrje nga përkthyesi, Skënder Hushi.
9.	-Kulti i Ufove dhe i ngarkesave.
24.	-Parathënie nga autori Mauro Biglino.
29.	-Tregues për leximet.
31.	-1-Për çfarë jemi duke folur.
38.	-2-El-i me emrin Yahweh(Zoti hebre) dhe mjetet e tij.
49.	-Shembuj OFO-sh në veprim tek bibla.
61.	-Koncepti i të shejtës.
70.	-Sipas librit të Kronikave 7,1 e në vazhdim.
75.	-Libri i Zanafillës.
81.	-Libri parë dhe i dytë i mbretit (Re).
85.	-Kampi.
87.	-Libri i dytë i Samuelit.
91.	-Ëndrrat dhe profecitë.
97.	-Miratimet nga bota kristiane.
100.	-Ruak, kavod dhe kerubinat e Ezekielit.
102.	-Reformat e Josias (Giosia).
123.	-Kerubinët.
126.	-Eden.
146.	-Arka e besëlidhejes.
149.	-Sistemi i ndërlidhjes.
164.	-Urim e Tummim.
166.	-Arka si armë.
180.	-Në përmbledhje.
182.	6-Elohimi-Yahweh dhe ari i hebrejve.
185.	-Materialiteti i priftit.
189.	-Ishte me të vërtetë Deti i Kuq?
196.	-Viçi i artë.
206.	-Teknologjia e Elohimëve dhe Adami.
209.	-Meshkujt elohim dhe femrat adame.

- 223. -Eva.
- 225. -Kirurgët elohimë?
- 229. -Eva nëna e të gjallëve?
- 231. -Në përfundim: krijim, evolucion apo...
- 234. -Krijim apo...
- 238. -Zanafilla (Gjeneza) 5,1-2.
- 252. -Konsiderata të përgjithëshme.
- 255. 9-Inxhinjeri hidraulike?
- 258. -Ujërat dhe toka e thatë.
- 261. -Raçia.
- 264. -Poshtë digës.
- 267. -Tregimet jasht biblike.
- 269. -Vërtetime biblike.
- 274. -Vërtetime sumero-akadiane.
- 279. -Në përfundim.
- 283. -Shtesë.
- 286. -Lista e shkurtimeve të përshtatura.
- 287. -Të dhënat sipas numrave.
- 289. -Bibliografia (tregues i vend-ndodhjes së studimeve të ndryshme).
- 297. -Libra të tjerë të autorit.

HYRJE

Nisa punën me këtë libër serioz të mikut tim Mauro Biglino, sepse shoh që ka shumë të vërteta.

Shumë studiues të shkencës, fillozofisë, fetarë etj, po pranojnë se pjesa më e madhe e teorive të sotme të besimit në një “Zot” (monoteiste), në zanafillë të tyre, shumë ngjarje e histori i kanë marrë nga ngjarje të vërteta, që kanë ndodhur në të kaluarën, por që duke mos pasur njohuri të mjaftueshme, i shndërruan në ndodhi, që kishin lidhje me Zotin dhe engjëjt e qiellit. Autori Mauro Biglino, faqe pas faqeje, na zbulon me durim e aftësi se ajo çfarë është shkruajtur në Bibël, nuk është një ndodhi, që ka si aktorë Zotin Njësh dhe engjëjt, por flitet për njerëz jasht tokësorë, (shumë Zota) me njohuri shumë më të thella se ata të njerëzve të kohës së Mose-Musa. Ndodhi të ngjashme bota i ka hasur në kohë të ndryshme, edhe në shekujt XIX dhe XX, kur në ishujt e Paqësorit, që banoheshin nga një popullsi, që nuk kishte lidhje me botën që po zhvillohej e që, u ndjenë të mahnitur nga takimi me njerëzit “modernë”, të cilët fluturonin me “zogj metalikë” dhe lundronin me “katunde metalike” (anijet). Këto histori i kam marrë nga interneti dhe i kam shtuar në këtë libër, që të bëhet më bindëse ideja e librit të M. Biglino për lexuesit. Ajo që më ka tërhequr më shumë në këtë libër është edhe shpjegimi i shumë emrave dhe fjalëve, për të cilat kam diskutuar edhe me autorin, ku i shpjegoja se me anën e gjuhës shqipe u dilte më i saktë kuptimi shumë emrave dhe fjalëve, për të cilët autori bën përpjekje t’i shpjegojë me anën e gjuhëve të “vdekura”. ***Ai i pranoi mendimet e mia e prandaj ma dha menjëherë lejen për përkthimin e botimin e këtij libri në gjuhën shqipe, duke më dhënë të gjitha të drejtat për këtë botimin që po bëj.***

Shof se historitë e Biblës janë kopjim nga librat e Thotit, nga “Ligjet e perëndeshës Mat” dhe nga shumë histori të përshkruara më parë në shkrimet kuneiforme të gjetura në

Babiloni. Emra njerëzish, vendesh, kullotash, objektesh etj, të përdorur para më shumë se 4 000 vjetësh, ashtu si fjalët dhe emrat ke libri “Pllakat prej zmeraldi të Thotit”, mbi 12 mijë vjeçare, tingëllojnë sikur po fliten me shqipen e sotme. Autori mundohet t’i shpjegojë me interpretim, siç po mundohen edhe vetë hebretë, që nuk e njohin “gjuhën e tyre” të vjetër, ndërsa shqipja “u bie në kokë” me të folurën e sotme. Qysh nga fjala israeli=israili=isht ra ylli, na tregon se ai popull, ishte pellazg, ashtu si ilirët, ishin me të njëjtën zanafillë, atë yllore, siç e ka dhe e ruan vetëm populli ynë, që ka ruajtur deri në ditët e sotme të pandryshuar gjuhën, veshjet, zakonet e shumë lidhje me lashtësinë.

Autori Niko Stylos, në librin e tij “Etruskishte-toskërishte”, faqe 78 na sqaron se judejtë (hebretë-israelitët) kanë qenë pellazgë dhe gjuha tyre ishte gjuhë shqipe-jonike. Gjatë librit ai e shpjegon më mirë këtë thënie.

Nga studimet e fundit, që po bëhen dhe po bëj edhe unë, emrat e shejtorëve dhe pjesëmarrësve në ngjarjet e lashta fetare apo legjendare, kanë pas ekzistuar në hapsirat pellazgo-ilire, para se sa të lindnin fetë që janë sot. Popujt e tjerë, duke pas ndërhyrjet e gjuhëve fetare, që sipas autorit *Zakaria Sitkin*, dhe të tjerë të përmendur edhe nga ai, në librin “*Planeti 12*”, morën urdhër nga forca (aliena), që janë kundër njerëzimit, që të krijojnë shumë fe dhe shumë gjuhë, që popujt të mos e ndjenin më veten si vëllezër, por si armiq e të vriteshin e rralloheshin në luftë me njëri-tjetrin. Feja e fillimit mbi tokë ishte feja e Thotit të Atlantidës, ajo e “Treshes druide”, e përcuar gjer në ditët tona nga bektashijtë, eremitët e murgjërimit nga India e kudo nëpër botë, me besime të ndryshme, e të tjerë që u mungon fanatizmi dhe falen kryesisht duke kaluar në trans-në lidhje të drejtë përdrejtë me hyjnoren dhe që mundohen të përhapin nëpër botë bashkim, vëllazërim e shkueshmëri. Mendoj se Bibla dhe të gjitha librat e tjerë të feve monoteiste janë ndërtuar në bazën e historive shumë më të

vjetra se sa datat e dhëna në Bibël (që ka shumë pasaktësi), nga ku kanë marrë zhvillim fetë hebreje, kristiane, ku edhe Kurani ka marrë e komentuar shumë pjesë e ndoshi. Shumë fanatikëve, të të gjitha feve monoteiste, ndoshta nuk do u vijë mirë nga këto fjalë e nga ky libër, por i këshilloj ata të ulen me këmbë mbi tokë, ta rruajnë leshin, që u ka mbirë ke sytë e t'i pastrojnë mirë ato, që ta shofin fqinjin me fe të ndryshme si vëllain e vet e jo si një objekt pa vlerë, që mund ta vrasë e të bëjë ç'të dojë ndaj tij. Duhet t'i thërrasin mendjes, sepse nëse mendon po ashtu kundërshtari i tij, edhe ai nuk ka vlerë dhe fundi do jetë një luftë e pamëshirshme, deri në zhdukjen e gjithë racës njerëzore (fanatikë me fanatikë të kundërt, që s'i hapin rrugë njëritjetrit, ose fanatikë me të pambrojtur me fe të kundërta).

-----0000000-----

Për të punuar më shpejt, këtë libër e kalova edhe në "Përkthyesin e kompjuterit-*Google translate*", por me keqardhje vëreja se aty kishin futur një sasi të madhe fjalësh të huaja, si fjalë shqipe dhe, kam hequr shumë siklet, që shumë fjalë t'i zëvendësoj me fjalë të njëvlefshme të shqipes. Ftoj edhe shkrimtarët dhe studiuesit e tjerë, që shkruajnë, të mundohen ta shkoqisin-shohisin me imtësi gjuhën tonë nga fjalët e huaja, të cilat duhet të shihen si hime-krunde e jo si fjalë me vlerë. Edhe ngrehinat (institucionet) shtetërore, që kanë punësuar njerëz për të punuar në internet, për vendosjen e fjalorit të shqipes atje, duhet t'u kërkojë hesap (hasapë=es-ap=as-ap=llogari) atyre studiuesve, që po zëvendësojnë, heqin e fshijnë fjalët e gjuhës sonë të lashtë. Kjo gjë të kërkohet edhe tek librat e shkollës fillore, ku të shtohen fjalët tona hyjnore e të fshihen fjalët e huaja nga gjuha shqipe.

Ju uroj lexim të këndshëm dhe shpresoj, që sado pak të kem ndriçuar të vërteta, që janë mbajtë fshehur gjer më sot.

Skënder Hushi

Kulti i qiellit dhe UFO-t në Egjiptin e lashtë Kulti i ngarkesave (i kargos)



Këto figura kanë dalë në një nga piramidat e Egjiptit, pas shembjes së suvasë.

Nuk kemi nevojë të shohim mbrapa 5 mijë vjet e më shumë, për të gjetur prova të takimeve të qenieve njerëzore me mjetet metalike që fluturojnë në qiell.

Një ndodhi që antropologët e quajnë "kulti i ngarkesave" filloi të çfaqej në ishujt e largët të Paqësorit Jugor pas fundit të Luftës së Dytë Botërore. Vendasit (aborigjenët) "e egër", që jetonin larg qytetërimit, formuan besimet e qiellit pas dhuratave materiale që binin nga qielli si pikat e shiut nga pilotët amerikanë dhe japonezë. Këta ishullorë kurrë më parë nuk kishin parë aeroplanë. Pra, imagjinoni tronditjen dhe gëzimin, kur shihnin të fluturojë një aeroplan të madh bombardues, plot me ushqime e mallra të tjera, që ua

hidhte atyre nga qielli. Pastaj imagjinoni hutimin dhe dëshpërimin e tyre, kur avionët u zhdukën dhe ushqimi ndaloi së rëni nga qielli.

Gjatë luftës se dytë botërore, ushtarët amerikanë dhe japonezë krijuan baza ushtarake të përkohëshme në shumë ishuj të paqësorit. Pasi kishin arritur në ishuj nëpërmjet detit, hodhën me parashuta sasi të mëdha materialesh industriale dhe ushqimore, që përbëheshin nga ushqime të konservuara me kutija, çadra, ilaçe e armë dhe kështu krijuan bazat e tyre strategjike në mes të oqeanit. Më pas shpyllëzuan pjesërisht bimësinë e ishujve dhe ndërtuan baza (aerporte) për uljen e aeroplanëve, duke krijuar ura ajrore, që kishin si qëllim furnizimin me materiale të ndryshme për ushtarakët, që do mernin pjesë në veprimet ushtarake.

Në këto ishuj jetonin edhe “tribu”-vendalij të izoluar, që bënë një jetë të prapambetur, që nuk ishin në gjendje të kuptonin shkallën e zhvillimit të ushtarakëve, apo qëllimin e ardhjes së tyre të papritur. Vandalijtë (indigjenët) shikonin ushtarët, që arrinin nëpërmjet detit me anije të mëdha sa “katundi i tyre” dhe nga qielli vinin me anën e “Zogjve të argjendtë”.

Të mahnitur nga çfarë shihnin, vandalijtë nuk tregun fare shenja armiqësie ndaj ushtarëve, përkundrazi, i mirëpritën dhe rrespektuan si një popull “i shejtë” që u kishin zbritur nga qielli si të dërguar nga Zoti-Zotat dhe ngelnin shumë të mahnitur nga aparaturat e tyre dhe nga pasuria e ardhur në formë të ndryshme e në ushqime. Vendasit me atë rast përfituan shumë të mira materiale, që nuk i mendonin e nuk i kishin parë më parë, të cilat ua jepnin me bollik ushtarët, si ushqime ashtu edhe mjete të ndryshme për jetesë (vegla pune, veshmbathje, etj) me vlerë të pallogaritshme për ato popuj.

Kur lufta mbaroi ushtritë braktisën bazat ushtarake nëpër ishuj dhe furnizimi i rregullt me ushqime, veshmbathje e

vegla pune u ndëpre.

Meqënëse vendalijtë mendonin se gjithë ato të mira materiale e ushqimore ishin dërguar nga qielli pikërisht për ata nga Zoti dhe hyjnitë, zhvilluan ceremoni e praktika fetare, që të rifillonte përsëri ardhja nga qielli i atyre të mirave materiale, që u ishte ndërprerë.

Këto praktika besimi (kulte) përmbanin rindërtimin me kashtë e kallama të formave të aeroplanëve dhe paisjeve të tjera, që kishin parë të përdornin e të udhëtonin “populli i shejtë”(ushtarakët), që u kishin zbritur nga qielli e nga deti. Ata luteshin, që t'i mernin me të mirë, që të riktheheshin. Kjo dukuri është quajtur “Culto di cargo=Kulti i ngarkesave (ndihmave)” dhe sigurisht nuk është një rast i veçantë, sepse është vënë re shpesh në popullsitë, që bëjnë jetë primitive, kur ata takojnë me njerës të sotëm, që përdorin makineri të përparuara.

Kulte të ngjashme janë vërejtur edhe para Luftës së Dytë Botërore në Guinenë e Re dhe në Mikronezi midis viteve 1800 dhe 1900, si rezultat i kontaktit në mes grupeve të vendasve indigjenë dhe ardhësve europianë. Një prej rasteve të para të dokumentuara për "kultin e ngarkesave" ka ndodhur në ishujt Malanesia në vitet 1800. Këto popujt zhvilluan kulte (besime) që ishin midis fesë dhe histerisë të përbashkët të gjithë gjinisë atje dhe objekti i besimit të tyre ishin mallrat që ndodheshin në ngarkesat e anijeve tregtare, që shkarkonin në ishujt. Vendasit mendonin se pasuria ishte dërguar nga paraardhësit e tyre (të vdekur), kështu që në disa raste ata braktisnin të gjitha llojet e punëve dhe ia përkushtonin veten lutjeve të gjata, në pritje të arritjeve të mallrave të reja. Në Papua të Guinesë së Re nga kjo çmenduri e gjithë gjinisë (histeri kolektive) rrodhën shumë ngjarje dramatike, që mbahet mend si "*Çmenduria e Vailalas*". Vendasit braktisën punët dhe lanë të shkatërrohen të lashtat dhe feramat, duke djegur edhe shtëpitë e tyre prej kashte dhe filluan t'i përkushtohen

vetëm lutjeve në qiell, duke pritur ardhjen e ngarkesave të tjera. Shpesh është vërejtur se “kulti i ngarkesave (të mallrave)” ndodh sa herë që një popull primitiv hyn në takim me një teknologji të përparuar, që në sytë e tyre është krejtësisht e padallueshme nga magjia, ose nga diçka hyjnore, e dhënë dhuratë nga qielli dhe hyjnitë. Në këtë pikë, mund të hamendësojmë se gjatë gjithë historisë ky fenomen ka ndodhur shumë herë, duke prodhuar një numër të madh mitesh dhe legjendash.

Po ashtu edhe për shumicën e feve, që janë sot nëpër botë, siç do t’i shikoni në këtë libër.

Në 1871 baroni rus *Nikolai Miklouho-Maclay* me hulumtues të tjerë u bënë kolonët e parë të bardhë në Madang, të Guinesë së Re. Kur ata arritën me anijet e tyre të mëdha, popullsia vendase e prapambetur nisi të besonte se rusët ishin paraardhësit e tyre të vdekur prej shumë kohësh, e që u kthyen si perëndi. Baroni i habiti vendasit me shpikjet "magjike", si dinamit, çamçakis, dhe fenerë. Pasi rusët u larguan, vendasit filluan të luteshin për kthimin e tyre, dhe më në fund u gëzuan shumë, kur më 1884 arritën në brigjet e tyre të tjerë burra të bardhë. Qeshja në fytyrat e vendasve nuk zgjati shumë. Indianët shpejt zbuluan se këta të huaj nuk kishin sjellë ndonjë të mirë. Kolonët gjermanë i detyruan vendasit të punojnë në plantacionet e tyre të reja. Indianët atëherë ngritën krye kundër shfytëzuesve të tyre, por zbuluan një tjetër shpikje "magjike" të njeriut të bardhë, pushkën Winchester, që mbushej shpejt dhe ishte vdekjeprurëse.

Prej disa dekadash, marrëdhëniet racore midis ishullorëve vendas dhe misionarëve të bardhë dhe industrialistave të ardhur nga vende të ndryshme filluan të prishen në ishujt e largët të Paqësorit Jugor. Shumica e banorëve të ishujve filluan të besonin se njerëzit e bardhë mbanin peng hyjninë e tyre brenda një vullkani, diku në Australi. Këto besime vazhduan deri në Luftën e Dytë Botërore, kur japonezët

filluan të zënë shumicën e ishujve të Paqësorit. Në sajë të shiut të mallrave, që u hidhnin nga qielli, ishullorët filluan të besonin se japonezët kishin shkuar për të shpëtuar ata dhe për të dëbuar të bardhët nga ishujt.

Japonezët ishin të lumtur dhe i nxisnin këto besime, sepse ata ishin duke luftuar për jetën e tyre kundër forcave aleate. Pas marrjes së armëve, popullsia vendase ishte e gatshme për të sulmuar të gjithë trupat e huaja, të cilët nuk ishin të veshur me uniforma japoneze. Armiqtë e tyre ishin të veshur me uniforma kamuflazhi dhe ishin të bardhë.

Paramendoni se sa u trembën dhe u hutuan ata, pasi panë luftëtarin amerikan *John Frum* të përplasej rëndë në tokë me aeroplan, nga pakujdesia, duke shkatërruar pemë dhe shkurre të ulëta, gjersa ndaloi në mënyrë të sigurtë pasi kishte bërë disa kilometra në xhungël. Mes tymit, që fluturonte nga motorët, Frum doli nga aeroplani. Vendasit vrapuan gjer tek aeroplani në tym dhe po shikonin me kureshtje Frum. Pas daljes nga avioni, *John Frum* hoqi helmetën e tij, duke zbuluar karakteristika afrikane të ngjashme me ato të vendasve ishullorë. ***John Frum*** ishte një pilot luftarak afrikano-amerikan. Për ishullorët vendas me ngjyrë, ky ishte një zbulim i madh.

Kur ishullorët filluan ta shikojnë Frum si një hero dhe avionin e tij si simbol të besimit (kultit) të qiellit, brenda pak kohësh filloi të rritej adhurimi hyjnor rreth tij. *Frum* fillimisht u dha karamete e çokollata dhe u miqësua me vendasit, derisa u shpëtua nga shokët e tij. Pas premtimit se do të kthehej dhe nuk u shfaq përsëri, banorët e ishullit e shndërruan kujtimin e *John Frumit* në një hyjni. Kulti i *John Frumit* vazhdoi të qëndrojë në këmbë edhe pas përfundimit të luftës së dytë. Vendasit ndërtuan formën e radios së plotë prej bambuje, me antena druri dhe me dega rrushi, që përfaqësonin kabllot elektrike. Në këtë “radio” “në formë lutjeje” përsëritnin fjalët që kishin dëgjuar gjatë luftës, duke



Figura te aeroplanit prej bambuje



përfshirë edhe kushtet (kodet), që flisnin ushtarakët si: "Roger, foks, bravo, over, lidhje, marrje, mbyllje etj." Gjithashtu bënë një rrip toke në formën e venduljes së aeroplanave, dhe ndërtuan kopje të avionëve me kashtë e palma dhe festimet vjetore (fetare) ia përkushtonin rikthimit të *John Frum*, i cili portretizohej duke shkruajtur në gjoks U.S.A. dhe ngrinin një shkop për të përfaqësuar flamurin amerikan dhe armët (pushkët) i bënë me kallama bambuje. Kulti modern i qiellit nxjerr në dritë shumë imtësi psikologjike që nënvizojnë atë që kemi parë gjithmonë: pajisjet teknologjike të panjohura që influencojnë mbi primitivët. Nëse vendasit e primitivë kishin vështirësi për të kuptuar bombarduesit e Luftës së Dytë Botërore në 1940, atëherë si mund të presim, që njerëzit e lashtë nuk do kishin të njëjtat probleme? Kur vendasit e Paqësorit të Jugut nuk kuptonin se si punonin aeroplanët, kjo i nxiti ata që të adhuronin aeroplanët.



Me shkrimin U.S.A ky vendas mendon se është duke nderuar "profetin" Frum.

Kjo është e lidhur me besimin tonë të lashtë në fe, dhe në mbretërinë e të mbinatyrshmes.

Kulti i qiellit e i ngarkesave, i parë në kohët moderne, na e bën të lehtë për të kuptuar atë që bënin të lashtët, të përshkruar mijëra vjet më parë.

“Libri egjiptian i të vdekurve”,

që njohim sot, nga egjiptianët e lashtë quhej: **“Reu nu Pert em hru”**, zakonisht i përkthyer si *“Kronika e ardhjes së dritës së ditës.”* Ky libër është një udhëzues i rëndësishëm, plot rite funerale (vdekjeje) dhe udhëzime për përgatitjen e egjiptianëve të lashtë në jetën e përtejme. Por kjo është bërë e mundur vetëm në një kohë të mëvonëshme në histori, kur priftërinjtë filluan ta shitnin (ta deklaroronin) këtë si një manual, që shpjegonte *“Si të mbijetojmë nga ferri (xhehnemi)”*. Sapo priftërijtë u bënë të vetëdijshëm se njerëzit shpenzonin shumë të holla dhe ishin të gatshëm të paguanin, për qëndrimin në parajsë, në jetën pas vdekjes, **filluan të përkushtohen në kontrollin e popullit përmes fesë e, që vazhdon edhe sot e kësaj dite.**

“Libri egjiptian i të vdekurve” përmban njohuritë më të vjetra me shkrim të botës dhe shkon shumë më thellë se magjitë e thjeshta dhe mjetet juridike e fetare të lashta. Koleksionet e shkrimeve të vdekjes shifen për herë të parë në varret egjiptiane rreth viteve 1600pes. Shembulli më i njohur i tyre, është **“Papyrusi i Anit”**, i ruajtur gjer tani në gjendje të shkëlqyer në Muzeun Britanik në Londër. Ky papyrus i famshëm përfaqëson një pjesë të vogël të arkivit të madh të teksteve egjiptiane në muze. Shumë pjesë të Librit të të Vdekurve nuk janë shpалosur për publikun dhe janë siç kanë qenë 3500 vjet më parë.

Megjithatë kemi dijetarë të cilët po përpiqen me kujdes për të shqyrtuar këto dokumente, në përpjekje për zbërthimin e tyre. Duke pasur parasysh që më shumë se 70 për qind e Egjiptit të lashtë është ende duke fjetur nën rërën e nxehtë

të shkretëtirës, dhe se mësimet e zanafillës së Egjiptit janë ndryshe nga ato që gjenden në përkthimet evropiane të 100 viteve të fundit. Shumica e dijetarëve pranojnë se dijnë e shumta 30 për qind të përmbajtjes së tij (të Papirit të Anit). Sigurisht, më vonë do rritet shkalla e studimit të tij. Pavarësisht përkthimeve të ndryshme, thelbi i përgjithshëm i teksteve egjiptiane ende mund të shkoqiten në mënyrë të saktë.

Kërkimi ynë për të dhëna, që çojnë në teorinë e astronautëve në Egjiptin e lashtë fillon me përkthimet e bëra nga gjuhëtari respektuar *E. A. Wallis Budge* në libra të letërsisë egjiptiane, përfshirë tregime, himne, vajtime, poezi, "*Librin e të vdekurve*" dhe shkrimet në formë kunjash (kuneiform) e të botuar në 1901.

Aty janë dhënë përshkrime të ndryshme të **anijeve kozmike** në lëvizje, që gjenden në shkrimet Egjiptase. Pikëpamja dominuese ishte që këto lloj mjetesh ishin thjesht anije të ndryshme të paracaktuara (destinuara), që të notonin në ujë. Por në qoftë se egjiptianët e lashtë mund ta shikonin lumin Nil si Rrugën e Qumështit, atëherë përse nuk mendojmë se ata ishin duke folur për anije qiellore, në vend të anijeve që kalonin ujin? Sigurisht, egjiptianët kishin barkat me vela, por duke pasur parasysh lashtësinë ekstreme dhe rëndësinë e shkrimit të tyre, duket më e logjikshme të mendojmë se ata ishin duke përshkruar skenat që përfshijnë hapësirën e lashtë kozmike, ndoshta të një kohë më të vjetër se ajo që ishte përshkruar në ditët e Ra-ma dhe Ezekielit.

Duke lexuar me mendjet tona të shekullit njëzet e një, do të gjejmë këtu më poshtë përshkrime nga "*Libri i Budge*" në formë poetike të qarta. Këto shkrime të hershme egjiptiane, veçanërisht ato në lidhje me Zotrat e fshehur në stacionet e tyre hapësinore apo në portet, flasin pa dyshim, për mjete të shpejta, që udhëtonin në hapësirë-kohë, ose drejt yjeve...

Mundet që shpirti i Osiris, Ani triumfues, të vijë së bashku me ju në qiell dhe të mund të shkojë përpara në anijen e Motet.

Mund ai të hyjë në port me anijen e Sektet dhe mund të bashkohet në rrugën e tij ndërmjet yjeve në qiell pa pushim. (Hymni i Ra: Papirusi i Anit N.10470, fletë 20).

*Ti do të kalosh mbi qiell dhe çdo herë do të shikojmë ty dhe rrugën tuaj, sepse ti ke qenë i fshehur nga sytë e tyre. Ty do të tregojnë vetëm në agim dhe në mbrëmje çdo ditë. Anija e Sektet, ku qëndron Madhëria yte, do të shkojë larg me forcë; Rrezet e tua [shndrisin] në [të gjithë] fytyrat; [Numri] i rrezeve tuaja të kuqe dhe të verdha nuk mund të jetë i njohur, as rrezet e tua të lehta nuk mund të numërohen. Tokat e perëndive dhe tokat lindore të **Punt** duhet të shihen para se ajo, që është e fshehur [në ju] mund të matet. Vetëm me veten çfaqesh, [kur] ti do të vish në ekzistencë, sipër Nu [në qiell]. (Himni Ra: Papirusi i Ani N.10470, fleta 20).*





Vendet e fshehta të duan, të moshuarit këtu do të bëjnë dhurata dhe do të krijojnë për ty fuqi mbrojtëse. Qëniet hyjnore, që jetojnë në horizontin lindor dhe perëndimor të transportojnë ty, dhe ata që janë në barkën e Sektet të transportojnë ty përreth (për xhiro-gjiro).

(Papirusi i Mut-Hetep N.10010, fletë 5)

Ja një përshkrim i thellë që na afron një kuptim të kapërximeve të mëdha në hapsirë e në kohë, që ndodhin gjatë udhëtimeve të gjata qiellore:

*Unë jam ai që vjen përpara, që përparoj, emri i të cilit është i panjohur. Unë jam i Djeshmi syçelë prej miliona vitesh. Ky është emri im. Jam hapi përgjatë shtigjeve të gjyqtarëve qiellorë hyjnorë. Unë jam zoti i përjetësisë, dhe dekretoj e gjykoj si zoti **Khepera**. Unë jam zoti i kurorës së Ureret. Unë jam ai që jeton në Utchat dhe në Vezë, (në gjithësi e në embrion S.H), dhe ajo më është dhënë mua për të jetuar [me] ta. Unë jam ai që jeton në Utchat, kur ai mbyllet dhe unë ekzistoj me të njëjtën forcë. Unë shkoj përpara e ndriçoj; Shkoj e vij nëpër jetë e kohë (përjetësisht). Unë jam në Utchal,*

në vendin tim e mbi fronin tim, dhe ulem në vendbanimin e lavdisë së Njishit. Jam Horus dhe nëpërkaloj në miliona vjet. . . Hap portat nëpër qiell, ku unë drejtoj fronin tim, dhe hap [rrugën] për lindjet (që do ndodhin) në këtë ditë. Unë jam Fëmija që marshon përgjatë rrugëve të djeshme. [Unë jam] sot për kombet dhe popujt e panumërt. Unë jam ai, njëshi, që ju mbron prej miliona vitesh, edhe në qoftë se ju jeni banorë të qiellit, ose të tokës, ose nga jugu apo nga veriu, nga lindja apo perëndimi, frika ndaj meje është në trupat tuaj. Unë jam kushdo nga ku qenia i është modeluar nëpër sy dhe unë nuk do të vdes përsëri. Copëzat e mia janë në trupat tuaj, por forma ime është në vendin tim ku banoj. Unë jam ai që nuk mund të dihet (njihet), por këta "Të kuqtë" kanë fytyrat e tyre të kthyer drejt meje. Këto janë të zbuluara. (Papirusi N.10477, fletë 6).

Tek libri i Budge, ka më shumë përshkrime të flotës ndërhapësinore dhe komandantëve të tyre hyjnorë, të cilët kanë zotëruar artin e klonimit dhe të udhëtimit në hapësirë, por edhe se si të ishin të padukshëm për njerëzimin:



Unë jam Dje, Sot dhe Nesër, [dhe] e kam fuqinë për të lindur për herë të dytë; [Jam] shpirti hyjnor i fshehur (i padukshëm S.H), që krijoi perënditë dhe i jap ushqim të vdekurve, banorëve të Tuat (të nëntokës), të Amentit, dhe të qiellit. [Jam] timoni i lindjeve, zotërues i dy fytyrave hyjnore nga ku rrezatimet e tyre janë parë sipër. Jam Zoti i njerëzve, që ngrihen lart; [Zoti] që del nga errësira, nga ku format e ekzistencës janë të shtëpisë ku ata vdiqën. Ju përshëndes, ju, o dy skifterë që jeni ulur në vendet tuaja të pushimit, duke bërë kujdes për gjërat që janë thënë prej atij, që drejton arkivolin në vendin e fshehur, ku kryeson Ra, dhe të ndjekin atë në postin më të lartë të vendit të shenjtë që buron në lartësitë qiellore! Unë jam i dërguari Perëndi. Nga shtëpia e çdonjerit, që banon në zotërimet e tij, dhe kam ardhë nga Sekhem për në Annu për të bërë të njohur shpendin (zogun) Bennu dhe të marr pjesë në ngjarjet e Tuat. Më lejoni të eci në paqe; më lejoni të kaloj mbi qiell; më lejoni të adhuroj shkëlqimin e shkëlqimeve [që është në] sytë e mi; më lejoni të fluturoj si një zog për të parë njerëzit e Khus ditë për ditë në prani të Ra, që i jep jetë çdo shpirt njeriu, që ecën në të gjithë vëndet që janë mbi tokë.

(Papyrusi Nebseni N.9900, fletët 23 dhe 24).

Ky ajet përmban përshkrime teknike të mahnitshme dhe me pasuri fjalësh, që mund të lidhen vetëm me mjetet e hapësirë-kohës:

Jam rritur, jam rritur si fajkua i fuqishëm [prej ari] që vjen jasht nga veza; Unë fluturoj dhe mundem ashtu si fajkoi, që e ka shpinën prej katër kubitësh të hapura (njësi matëse afërsisht 50 cm, S.H.), dhe krahët që janë të ngjashme me nënën e smeraldit, (guackat që përmbajnë zmeralde dhe kanë madhësinë e dy grushteve të bashkuar S.H) të jugut. Po vij nga brendia e barkës së Sektet dhe zemra ime erdhi me mua nga malet e Lindjes. Zbrita në barkën e Atet, dhe ata, që

ishin ulur në mes të popujve të tyre u kthyen nga unë dhe u përkulën për të më nderuar mua dhe për të më përshëndetur me klithma të gëzuara. Jam rritur, dhe mbledhur në veten time, si i bukuri fajkua i artë, i cili ka kokën si zogu Bennu, dhe (perëndia) Ra hyn dita-ditës për të dëgjuar fjalët e mia; Kam marrë postin tim midis të parëlindurve të Nut. (Papirusi i N.10477, fletë 10).

Në këto vargje kuriozë, duket se përshkruhet një tregim në vetë të parë, duke parë një anije kozmike dhe nënkupton se ky person ka bërë një fluturim në hapësirë, ose u lejua të fluturojë me një flotë.

Ja ku jam tani, sepse unë bëj këtë anije të fuqishme për të udhëtuar në liqenin Hetep, dhe e kam marrë me vete me forcë nga pallati i Shu; zotërim i dy yjeve, që bëhen gjithnjë e më të rinj duke ripërtërirë fuqinë e tyre të mëparshme. Solla anijen në liqenet e të njëjtëve (dy yje) në mënyrë që unë mund të vij drejt e përpara në qytetet e tyre, duke lundruar në qytetin e tyre hyjnor Hetep. Zoti Horus e bën veten më të fortë ashtu, si falkoi atje sipër, që është në jetë, një mijë kubitë i gjatë dhe dy mijë [kubitë] i gjërë, (besoj se është anije kozmike 500x1000 metra, S.H); ai është pajisur me ta (me krahët), dhe ai udhëton lart dhe vjen aty ku selia e zemrës së tij dëshiron, në qytetet e tyre. Ai është prodhuar në dhomën e lindjes të Zotit të qytetit, ai i ofron [ai i bën] ushqimin Perëndisë së qytetit, ai e bën atë që ai ka nevojë për të bërë këtu, dhe bashkimin e tyre, të gjitha në materien e dhomës së lindjes së qytetit hyjnor. Kur [ai] e përçmon jetën si kristali që e ka mbajtë të gjithë për vete, këto gjëra janë si drejtimet e gjërave, që pëlqen të bëjë në Liqenin e dyfishtë të zjarrit, në të cilin askush nuk gëzohet, dhe ku janë të gjitha llojet e gjërave më të liga. Zoti Hetep shkon dhe kthehet, dhe shkon përsëri në këtë vend e mbledh së bashku të gjitha llojet e gjërave për në dhomën e lindjes së Zotit të qytetit.

(Sekhet-hetepet.: Papirusi i Nebsen N.9900, fleta 17).

[Tungjatjeta-lavdi], ju të ndritshme dhe të shkëlqyeshme flakë, që mbani vendin tuaj mbi shpatullat e Ra, që mund të ju vrasë (nëse rrini) prapa tij, anija e Ra është në frikën e turbinave dhe stuhive; Më parë shkëlqen, pastaj bëhet e dukshme. Kam ardhur [ditën] bashkë me zotin SEK HRA nga gjiri i liqenit të tij të shenjtë, dhe e pashë Maat [zonjën] që kaloi, dhe zotat luanë, që i përkasin atyre. Kam krijuar një rrugë (një shkallë) përballë ballit të anijes së Ra dhe u ngrita në diskun e tij hyjnor. Unë jam ai që banon midis perëndive, erdha, më lejoni të kaloj përsëri me anijen e zotit Sa. Ja, o Heru-ur, ekzistonte një flakë, por zjarri është fikur. E bëra rrugën [time], o Ju etër hyjnorë dhe majmunët tuaj hyjnorë! (Papirusi i Nu N.10477, f. 28).

“Përsëritjet e mërzitshme të Ra (Litanie di Ra)” janë shkrime të lashta egjiptiane. Riti i specifikuar në këtë tekst u gjet në Tebë, në muret që zbukurorin varrezat faraonëve. Edouard Naville ka përkthyer këto pjesë nga tekstet e botuara në Francë në vitin 1875 dhe tani ruhet në Muzeun Britanik:

Homazh për ty, Ra! **Pushtet suprem**, i vetmi, trim, me kurajo, që formëson trupin tënd, je ai që thërret perënditë e tij [përjetësisht], kur ai arrin me **sferën** e tij të fshehur.

Pushtet suprem, nga i cili çdokush shkëlqen kur është në **sferën** e tij, e i dërgon terrin e vet në **sferën** e tij, dhe që fsheh atë që përmban. . . ai që ndriçon trupat që janë në horizont, ai që hyn në **sferën** e tij. . . ai që zbret në **sferat** e Ament-it, forma e tij është e kthyeshme (e ndyshueshme) . . . urnë e krijesave, që bashkon substancat lëvizëse, forma e tij është ajo e Horus. . . do shkëlqesh me atë që shkëlqen në ujërat me dallgë përmbytëse, forma e tij është ajo e **Nun** dhe del vazhdimisht nga shpella e tij misterioze. . . Mbretëruesi Osiris është si çdonjëri prej atyre, që flasin në **sferat** e tyre të fshehta. Perëndi i **diskut** me rrezet shkëlqimtare, që ndrisin

*në **formë trekëndëshi** që shfaqet në vend të ndritshëm, ... hyn në brendësi të **diskut** të tij të bardhë, ndez hapsirën qiellore me rrezet e tij, që ai krijon dhe bën që shpirtrat të qëndrojnë në trupat e tyre, lëvdojeni atje lart, në vëndnderimet e tyre. Ai merr brohoritjet e tërë perëndive që hapin dyert, mer për qëndrimet e fshehura, që përgatisin rrugën për tek shpirti i Ra, dhe lejojnë Mbretin e shpirtrave të zbresë fushave. Ai kalon (ecën) nëpër disk me veten e tij.*

Nëse krahasojmë atë që dimë për teknologjinë e sotme, disa nga përshkrimet në këto dokumente duken se janë më shumë për anijet kozmike dhe alienë, që punojnë në bashkëpunim me njëri-tjetrin. Rrënjët e këtyre mistereve mund të ndiqen gjatë gjithë rrugës, gjer në fillimin e mitologjisë egjiptiane, ku ka pasur edhe shumë qenie-njerëz, që mendohen me origjinë jashttokësore.

Materialet janë marrë e përpunuar nga unë S.Hushi tek:
<https://www.facebook.com/CiviltaAnticheEAntichiMisteri>.

Parathënie nga autori M. Biglino

Është e nevojshme të paraqisim këtu vlersimet e përgjithshme në dobi të një kuptimi të mënyrës së ndjekur në kryerjen e këtij studimi, që vazhdon idenë e dy librave të mi të parë.

Janë shkruajtur shumë tekste, që përballen me çështjen e mundësisë së takimeve me qytetërimet jashtetokësore, ose me qytetërimet më të zhvilluara tokësore; libra që kanë krijuar hamendësime se këto qytetërimet janë në zanafillën e lindjes sonë dhe të evolucionit tonë, si fizik ashtu dhe kulturor. Ky prodhim i pasur librash trajton këtë çështje duke përmendur dhe shoshitur edhe disa pjesë të Dhiatës së Vjetër mbi bazën e përkthimeve të njohura të Biblës, që shumkush i ka në shtëpi.

Ama ekziston një mundësi për të mësuar më shumë, të shkojmë më thellë, për t'i kthyer hamendësimet në një siguri të vërtetuar e të kemi përfundime të sakta. Duke filluar nga Dhiata e Vjetër, në këto faqe do të vazhdojmë tregimin e atyre gjërave që ende nuk janë zbuluar, apo, edhe më keq, ishin harruar me dashje, ose ishin hamendësuar në mënyra të ndryshme, që të fshehin efektet e mundshme përçarëse që mbartin.

Pashpjegueshmëria doktrinale e shumë rrjeshtave biblikë, ka detyruar shkoqitësit e Biblës dhe teologët e të gjitha kohërave të përdorin kategorinë shpjeguese me anën e alegorive, metaforave apo të miteve.

Me këto çelsa leximesh dhe shpjegimesh është deklaruar, që në rrjeshta të caktuar, kuptimi i menjëhershëm me lexueshim fsheh një tjetër kuptim më të rëndësishëm e më të thellë, i cila është vlera e vërtetë e tekstit. Është pohuar se autorët biblikë, në rrjeshtat, që gjykohen si të papranueshëm, ose të paktën të diskutueshëm në mendimin fetar, i kanë zëvendësuar me shprehje të tjera, që lidhen me të parët me një raport të mbivendosjes së pjesëshme semantike, ose kanë futur një gjuhë figurative të përshtatur. (*Sematike*=fjalë dhe shprehje shumë të vjetra, që interpretohen në disa mënyra. Edhe gjuha shqipe ka shumicën e fjalëve me disa kuptime, që krijojnë me mijëra interpretime, që, siç do e shohim gjatë leximit të këtij libri, do i japin kuptimin e duhur shumë e shumë shprehjeve të diskutueshme në Bibël. *S. Hushi*).

Gjëja kurioze, që mendojmë se është me të vërtetë e papranueshme, është se alegoria, metafora, miti, përdoren nga përkthyesit dogmatikë veçanërisht për të shpjeguar ato pjesë të tekstit, që janë në kundërshtim të plotë me doktrinën, që, ashtu siç kanë qenë formuluar nga autorët e lashtë, nuk mund të pranohen dhe të përfshihen në përmbajtjen e besimit.

Pra termi i përgjithshëm "Elohim", për shkoqitësit

tradicionalë, do të thotë gjithmonë pa keqkuptim "Zot, Perëndi", me përjashtim të *Psalmit* 82, i cili thotë se Elohim-ët" vdesin si Adami": në atë rast përkthyesit, për të qenë në një linjë me doktrinën, thonë çuditërisht që "Elohim" nuk don të thotë më "Zoti", por "Gjyqtarët" dhe bëjnë shumë përpjekje për ta rizgjidhur çështjen shumë të mprehtë me këtë mashtrim.

Këtë rast mundohen ta pranojnë si të vërtetë, edhe nëse mohohen vlerësimet në rrjeshtat e mëparshëm. Por edhe duke bërë kështu, mbeten në arsyttime të papranueshme, të cilat duhet të mos pranohen e të dëbohen. Duke mos qenë në gjendje për të zgjidhur çështjen, teologët menduan të bëjnë futjen e kategorisë së misterit: misterin e besimit, misterin e Zotit.

Në punën tonë jemi duke u përpjekur për të miratuar një afrim, që lejon një kuptim të drejtë, të thjeshtë, të fjalëpërfjalshëm, të qenë dhe të qëndrueshëm, në mënyrë, që të mos kërkojë hamendësime të tjera shqjegimesh fetare, e aq më pak, ato të misterit, i cili është në gjendje të pranojë çdo gjë pa pasur nevojë për të shpjeguar asgjë. Nuk mendojmë se zotërojmë të vërtetën, por i paraqesim të pranishmëve këtu atë që vazhdojmë të zbulojmë me prova të kujdesëshme të asaj që lexojmë, atë që teksti biblik rrëfen në dorëshkrimet e vjetra:

"Bibla e Stutgartit", e hartuar mbi bazën e dorëshkrimit të *"Kodit Masoretik"* të Leningradit.

Siç është bërë për punën e mëparshme, në të cilën të gjitha rrjeshtat janë të pranishme në mënyrë të qartë, përmbajtjet e pazakonta, të papritura, të jashtëzakonshme, janë dhënë në gjuhën origjinale me një përkthim besnik të fjalëpërfjalshëm, ku jepen me besnikëri fjalë për fjalë, duke përdorur një sistem ku merren për bazë shkrimet origjinale, që i afrojnë lexuesit mundësinë që të ketë një qasje të drejtpërdrejtë me Bilbën e vjetër të shkruar. Kjo punë ka lindur nga dëshira për të kryer një analizë të

tekstit, duke përdorur kuptimin origjinal të rrënjëve të bashtingëlloreve, që janë baza e fjalëve hebraishte, një kuptim që është treguar në fjalorët e hebraishtes aramaike biblike si dhe në studimet e etimologjisë dhe leksikografisë së gjuhës hebraishte të veçuar në Dhiatën e Vjetër. Një studim, që ndjek plotësisht mënyrën, që karakterizon të gjithë mendimin hebre, të mishëruar plotësisht në diskutimet e hapura dhe nga shpjegimet jopërfundimtare në besim, që, siç thuhet tek Talmudi: "Torah nuk është në qiej" ¹, një aprovim i bërë për të mbështetur pavarësinë e interpretimit rabinisht nga ndërhyrja hyjnore.

Nevoja për të analizuar pa pushim e duke u vendosur vazhdimisht përballë bindjeve të çdo njeriu (çifut), çoi në ndërtimin e një tradite që jeton me komente, me shpjegime të kundërta me njëra-tjetrën dhe për këtë arsye është vazhdimisht e pasigurtë e gjithmonë në gjendje kritike, e përfaqësuar nga një thënie popullore, që shprehet me saktësi në thënien: -Një çifut-dy ide, tre çifuta-pesë ide. Me respekt dhe përlulesi përpiqemi për të futur veten në lirinë e analizës me një punë, që karakterizohet nga zgjedhje të sakta. Tekstin hebraisht origjinal e përkthejmë fjalë për fjalë, por mbi të gjitha, me dëshirën që të mbajmë qartësi shumë të madhe gjatë arsytimeve.

Studimi i shumë zbërthimeve të lashta gjuhësore, që shpesh përmbajnë rezultate të qarta dhe të pranueshme botërisht, na ka detyruar të zgjedhim një afrim, që përqëndrohet në aftësinë për të zbuluar një fije të përbashkët, që qëndron në themel të tregimeve Biblike. Një shqyrtim i kryer në fund të punës vërtetoi, se kjo zgjedhje ishte e dobishme për të mbajtur një drejtim gjatë leximit dhe zbuloi qartësinë arsyetuese, të aftë të shpjegojë atë që shpesh gjuhësia, sidomos kur është e varur nga forma të ndryshme mendimesh fetare, i lë të pazgjithshura.

Le të themi se për të mirën e akademikëve, në tekstin tonë nuk do të gjejnë komente mbi këtë temë, mbi mundësinë, se

ndonjë shprehje mund të konsiderohet si një "fjali relative e çmendur" apo "fjali, frazë me shprehje te ndërlikuara". Nuk jemi munduar të marrim meritën që të hyjmë në shpjegimet e teksteve e të merremi me vlerat e zbërthimeve gramatikore-sintaktike, për të cilat merren shpesh shpjeguesit tradicionalë.

Kryesisht u përpoqëm të lexojmë tekstin, me besimin se ata që e shkrojtën atë, nuk u interesonin këto gjëra.

Kamal Salibi 2, profesor në Universitetin Amerikan të Bejrutit, i cili ka mbikqyrur e përpunuar "*Kodin e Leningradit*", thotë se shpjeguesit e teksteve të vjetra ebreje, janë marrë me përcaktimin e fjalëve të veçanta dhe shpjegimin e tingujve vokalë dhe nuk kishin njohje të thellë të gjuhës ebraike, pasi ata flisnin gjuhën aramaike.

Një konsideratë të veçantë kemi për profesor *Giovanni Garbini* 3, profesor i Filologjisë Semite në Universitetin La Sapienza të Romës, i cili na thotë se Masoretet (shpjeguesit) e ebraishtes kanë punuar mbi bazën ideologjike e teologjike dhe jo gjuhësore.

Pra, hamendësojmë se shpjeguesit e ndryshëm të Testamintit të Lashtë (Dhiata e Vjetër), kanë dashur të tregonin atë çfarë kishin parë ose dëgjuar për gjithë ato mrekulli dhe çudi, që janë të pashmangshme në përmbajtjen, të cilat ne i kemi trajtuar në një mënyrë të veçantë dhe që i paraqisim në punimin tonë.

Mrekullia dhe çudia, që na kanë ndikuar në këtë hulumtim të mrekullueshëm, shpresojmë t'i kalojë edhe lexuesve dhe më e rëndësishmja është se jemi munduar ta përshtasim edhe për lexuesit, që e marrin për herë të parë në dorë këtë temë. Kjo është padyshim një zgjedhje personale e diskutueshme, por është e hapur dhe e deklaruar, për të sqaruar lexuesit për karakteristikat e kësaj pune, e cila mundëson një paraqitje të thjeshtë, përballë kirurgjisë gjuhësore, që do u kushtohen analiza të veçanta. Për këtë qëllim pasazhe (rrjeshta, paragrafë) të ndryshme biblike

janë mbledhur nganjëherë në të njëjtin kapitull në mënyrë, që të vlerësojmë mvartësinë në përmbajtje dhe për të nxjerrë në pah vërtetimet, që secili mund t'i japë njëri-tjetrit, në këtë kuadër, që është duke realizuar ngadalë në këtë studim kërkimor. *Në Dhiatën e Vjetër janë bazuar së paku tri fe të mëdha, brenda të cilave ato kanë zhvilluar mënyra të ndryshme të të menduarit dhe kanë punuar historikisht, që të nxjerrin jashtë vëmendjes njëri-tjetrin, duke u përfolur e shajtë ndërmjet tyre.* Pra, në këtë mungesë të së vërtetës së besueshme e të pranuar botërisht, çelsi i leximit të dhënë këtu mundet të mendohet si një nga mundësitë e shumta: një nxitës për studime të mëtejshme. Përsa i përket paqartësive, që me domosdo karakterizojnë përcaktimet gjeografike ose takimin e ngjarjeve, ju kujtojmë se ata janë vazhdimisht të pranishme në studimet zyrtare dhe akademike, të cilat nxitën studiuesit *Feuerstein, Kak* dhe *Frawley* të rizbulonin se ekzistojnë probleme të bollshme në kapitujt ku mendimi i përbashkët kujton se ka njohuri të sakta. Nga titujt e shembujve të ndryshëm, një nga argumentat botërisht të studiuar e të shpërndarë nga ata, është dhe rizbulimi, që në rindërtimin e kronologjisë së faraonëve thonë.... "Duke pasur parasysh datat nga egjyptologët për Menes, [...] variojnë nga viti 5867 para erës së re[...] deri në 2224 para erës se re ", dmth se për historinë e Egjyptit të Epërm dhe të Ulët të punuar nga Menes, ka një ndryshim prej gati 3600 vitesh midis egjyptologëve. 4. Kujtojnë gjithashtu, që edhe data e pushtimit të kontinentit amerikan ka ndryshuar duke shkuar nga 400 vjet në 10-12,000 vjet më parë, por ka teori të sotme që e mendojnë përafërsisht 20-30,000 vjet më parë. Prandaj të vazhdojmë me qartësi. Kemi ende shumë për të nxjerrë në dritë dhe kërkimi duhet domosdoshmërisht të lëvizë përpara *me besimin se ajo që deri tani kemi menduar se e dinim, mund të mos jetë e vërtetë.*

Tregues për leximet

1) Vargjet në hebraisht me përkthim letrar.

Origjinalet e teksteve të vjetra hebraike janë shkruar vetëm me bashkëtingëllore, ndërsa mbas ndërhyrjes së “masoretëve” dhe “puntatorëve” (quhen shpjguesit e Biblës, S.H) u plotësuan me zanore të ndryshme.

Në rastet kur në tekstet kemi kërkuar t’i përmbahemi të folurës së gjuhës hebraike, kemi menduar të mos përdorim simbolet gjuhësore zyrtare, që mbeten të pakuptueshme për ata që nuk e dinë këtë gjë. Më pas janë lëvizur përsëri tingujt në mënyrën më besnike, që të jetë e mundur, duke përdorur zanore dhe bashkëtingëllore të gjuhës italiane, ngushtësisht të nevojshme, të ndjekura dhe me shpjegimin në italisht, (që unë do u shtoj edhe shpjegimin në shqip. S.H), për t’i bërë të kuptueshëm tingujt e futur midis dy llojesh, psh: **It**=[olot]. Jemi të bindur se ekspertët fonetikë dhe të përshtatjeve të gjuhëve do na kuptojnë arsyet për këtë zgjedhje.

Tabela e treguar këtu ilustron me thjeshtësi për sa u tha më sipër lexuesve: – rrjeshti i parë përmban tekstin hebre pa zanore dhe lexohet nga e djathta në të majtë; - Rrjeshti i dytë përmban përkthimin e fjalëpërfjalshëm, i cili gjithashtu duhet lexuar nga djathta në të majtë.

Shembull:

terra-la ancora benedire-a, lexohet: **=Për të bekuar ende tokën.**

(Që mos i besdis lexuesit, i hoqa gërmat hebreje dhe lashë vetëm përkthimin në italisht, që autori M. Biglino e ka bërë nga e djathta në të majtë, duke imituar gjuhën hebreje. S.H).

2) Termat sumeriane dhe akkadiane

Siç është thënë tashmë për ebraishten, për rishkrimet e përmbajtjeve që u përkasin gjuhëve sumeriane dhe akkadiane, janë zgjedhur për përdorim forma të thjeshtëzuara, pa përdorur simbole apo ndarje të shprehjeve në pjesët e tyre përbërëse, në mënyrë që të bëhet sa më i vogël ndryshimi i leximit e mos krijohet rrëmuje. Është përdorur forma më e vogël e shkurtimeve, sepse ajo është forma e përdorur zakonisht atje dhe e dobishme për të njohur e dalluar përfundimet.

3) Elohim, në njëjës dhe në shumës.

Në fjalor, fjalës "Elohim" i është përkushtuar një kapitull i tërë, që mundohet të shpjegojë përfundimisht e me saktësi domethënien e saj. Termi përmban përfundimin e shumësit në ebraisht, por në kapitujt e ndryshëm është ndërthurur shpesh me një artikull ose me një folje në njëjës. Kështu bën Bibla dhe kështu e bëjmë ne këtu, duke i mvësh Elohim-it aktin e besëlidhjes me Moisiun dhe popullin, që ai po ndërtonte e drejtonte.

Pra, kur thuhet se Elohim-Zoti ka kryer një veprim, nuk don të thotë që ka qenë i atij Elohimi, që ishte njohur nga ebrejtë me emrin Yahweh-Zot dhe që kishte mardhënie të veçanta me ata. (Në Biblën e shqipëruar nuk e kam parë fjalën Yahweh, por vetëm Zot. *S. Hushi*)

Jemi munduar të shmangim përdorimin e El (njëjës) dhe elohim (shumësi), që mund të krijojnë rrëmuje. Së fundi, simbas traditës, emrat e përveçëm do i shkruajmë me të madhe dhe të përgjithëshmit me të vogël.

1

Për çfarë jemi duke folur?

Bibla, disa herë ka qenë objekt i disa leximeve të

kuptueshme, por ndonjëherë tepër imagjinate, kështuqë shumë herë gjërat janë thënë në mënyrë teologjike, alegorike, metaforike, theosofike, anthroposofike, ezoterike-iniziatike, psikanalitike(!!??, S.H)...etj, etj.

Të gjitha leximet dhe shpjegimet që kanë marrë për bazë të dhënat nga Bibla kanë krijuar mendimin se Bibla ka qenë një mesazh shpirtëror i zbritur nga Zoti i vetëm, Krijuesi Madhështor i Universit. Megjithatë, jemi munduar të provojmë e të mendojmë se autorët biblikë donin të na tregonin me saktësi pikërisht atë që na thanë, pa fshehje, pa mistere, nëpërmjet shtigjesh të vështira dhe të errëta. E dijme që Bibla mund të lexohet, e me të vërtetë kështu është bërë gjatë shekujve, në plane të ndryshme, që janë njohur duke i krahasuar me fjalë të njohura në formim fjalësh, për të krijuar çelësat apo nivelet e leximit, si psh:

- **Peshat:** Lexim i rregullt, i fjalë për fjalëshm dhe i menjëhershëm.
- **Remez:** leximi alegorik, vepron për të dhëna, ose si vlera numerike.
- **Derush:** lexim homiletic. (Arti i shkrimit dhe shpjegimit).
- **Sod:** lexim i thellë, i fshehur, i tillë si kabalistikët 5.

Të tre nivelet e fundit të leximit janë ata të përdorur e paraqitur gjatë shekujve, si në mënyrë të pavarur ashtu dhe paralelisht e në grupe. Këshillojmë që të mendojmë sikur i pari, i fjalëpërfjalshëm, ka një vlerë, e cila deri tani ka qenë e nënkuptuar, për të mos thënë, e mohuar shpesh e qëllimisht apo e lënë pas dore, për shkak të papranueshmërisë së saj prej mendimit tradicional, i cili dëshiron të shohë tek Bibla atë, **që me të vërtetë nuk ka qenë qëllimi i autorëve të lashtë**, dmth nuk flet për një Zot, krijues shpirtëror, të plotfuqishmin e Gjithësisë.

Bëhet fjalë për një mënyrë të përkryer e të miratuar edhe nga historianët e mendimit të shkoqitjes judaike (giudaice), siç dokumentohet nga citatat e shkurtëra të sapa përmendura më lart, nga ku rrjedh se [**peshat**] është një

nga mënyrat me të cilat mund të lexohet Dhiata e Vjetër. Nuk është qëllimi ynë këtu për të shqyrtuar historinë shekullore e të rreptë rabinike, që kanë përfshirë gjatë shekujve komentues të ndryshëm, si psh: *Rav Hilled e Rav Smammai, Rav Aiva e Rav Ishmael, Rashi de Troyes* e të tjerë të rrymave të ndryshme maksimaliste apo minimaliste ... Për miratimin e vlefshmërisë dhe ligjshmërisë të metodës së përdorur këtu, do përmendim një aprovim të ndodhur në një nga volumet e *Jewish Publication Society* (New York), që mbledh punimet e mjeshtrave më të mëdhej të *Rabbinical Assembly* të SHBA. Dr *Jeffrey H. Tigay, Ellis* - Profesor i gjuhës dhe letërsisë hebreje dhe semite në Universitetin e Pensilvanisë në Filadelfia, i cili rijep në "*Etz Hayim*" (JPS, New York, 2005), mendimin e rabinëve për të cilët: "Torah is not metaphoric", dmth "Torah nuk është metaforik". Arsyetimi ynë është i ligjshëm, pavarësisht përpjekjeve për të nënvleftësuar, përkundër interesave dogmatike të zhvilluara, që qëllimisht bëjnë të kundërtën. Gjëja e re, që po shpалosim tani është se, në të gjitha pasqyrimet më praktike dhe më me baza kemi konsideruar "Dhjatën e Vjetër" si një libër të historisë, një tekst në të cilin autorë të ndryshëm të një populli, kanë dashur të tregonin me mjetet e tyre kulturore dhe gjuhësore, atë që ata me të vërtetë kanë parë.

Tani gjëndemi para përfundimeve të paramenduara: tregimi shpалoset para syve tanë me të gjithë pasqyrimet e tij të papritura.

Ky libër merret në mënyrë të veçantë me teknologji, që është e kudondodhur në tekstet biblike, kështuqë ka një qëllim për të deklaruar: të ndihmojë për shpërndarjen e informacionit mbi një pjesë të asaj, që në fakt nuk dihej në lidhje me çastet e origjinave tona, mbi rrënjët e njohurive të asaj gjëje, që me të vërtetë ka ndodhur mijëra vite më parë në planetin tonë.

Nuk është rastësi që titulli paraqet përmbledhjen e asaj që

është dokumentuar në dy kapitujt e fundit, në të cilët do të përfshijmë edhe atë që është konsideruar dhe paraqitet si akti hyjnor më i përsosuri, i ashtuquajtur "krijimi nga asgjëja", i cili nuk është më shumë se një nga shumë ndërhyrjet teknike dhe absolutisht materiale të bëra nga ata individë (elohimët S.H). Do të kuptoni se si mendimi teologjik ka vepruar tashmë qysh në ajetin e parë të Zanafillës, në përpjekjen e tij për të transformuar një histori, një kronikë, në një libër të fesë shpirtërore. Po të vazhdojmë deri në fund leximin e asaj që është shkruajtur në librat: **"Il libro che cambierà per sempre le nostre idee sulla Bibbia"** dhe **"IL Dio alieno della Bibbia"** (**"Libri që do të ndryshojë përgjithmonë idetë tona ndaj Biblës"** dhe **"Zoti alien i Biblës"**), do të përballemi me pasqyrime të veçanta e të ndryshme, po ashtu edhe me njohuritë teknologjike të atyre, që me të vërtetë kanë "bërë" shëmbëlltyrën dhe ngjashmërinë e tyre, (krijuan njeriun hibrid. *S.Hushi*).

Tek Bibla:

Nuk ka fe, nuk ka spiritualitet, nuk ka ekzoterizëm, nuk ka misticizëm kabalistik (ebre) ...

.... Kështuqë Bibla:

Ka informacion konkret, ka njohuri teknologjike vepruese, ka dokumentim të një të kaluarë të përjetuar tashmë nga njerëzimi.

Krahasuar me dy tekste të përmendur më sipër, këtu i është dhënë më shumë hapësirë hamendësimeve në lidhje me përmbajtjen biblike dhe hartimet teorike, që janë zgjeruar në mënyrë të mjaftueshme dhe të pasqyruara me studime të tjera jashtë Biblës.

Ka më shumë hapësirë për hamendësime, që ju lejon të paramendoni një tregim romantik të ngjarjeve, në të cilat Dhiata e Vjetër nuk jep njoftime të sakta, por lë të parashohësh ndodhi të shpërndara këtu e atje. Sinjalet, që

mund të zbulohen me një lexim të kujdesshëm dhe të përsëritur kanë aftësinë të shënojnë përputhjet e thënieve në dukje pa lidhje, **por që janë të lidhura nga një lidhje delikate, nga tentimi i mçeffjes, i mbulimit të kryer nga masoretët**, të cilët nuk kanë mundur t'i fshehin krejtësisht. Në punën e mëparshme kemi mbledhur dhe dokumentuar gjerësisht nga teksti origjinal dhe nga përkthimi i kryer ndaj teksteve hebraike më të lashtë, që janë pranuar botërisht, (*Kodi i Leningradit*), një seri të përmbajtjeve, që këtu nuk duam të përsëriten dhe e shohim të nevojshme të paktën të përpunojmë atë që është kusht i domosdoshëm për të kuptuar çështje të veçanta, të paktën nga ana e atyre që lexojnë këtë libër pa e ditur të kaluarën.

Përmbledhje e veprave të mëparshme

- Pjesa më e vjetër e Biblës është në thelb një libër historie, që tregon origjinën e njerëzimit dhe historinë e mëvonshëm të një populli, që ka krijuar një marrëdhënie dhe aleancë me një nga elohimët, me atë që është njohur me emrin Yahweh (Zoti-në ebraisht). Nga *Robert Wexler* (Universiteti i Judaizmit, Los Angeles) është shkruajtur në citatin "*Etz Haym*", se nuk është e besueshme historia që tregohet tek *Zanafilla* e që ta ketë origjinën në Palestinë.

- Elohim-at biblikë nuk janë një "Zot" i vetëm, si ngulmon teologjia për dy mijëvjeçarë, **por një shumësi individësh prej mishi**, një shumëllojshmëri e qartë dhe pa mëdyshje e regjistruar në Dhiatën e Vjetër.

Po përmbledhim karakteristikat bazë, të dobishme për të futur temat e zhvilluara në kapitujt në vijim:

- Ata ishin qenie, që jetonin aq gjatë sa për t'u konsideruar të pavdekshëm, edhe në qoftë se ata nuk ishin. Në botimet e përmendura kemi parë pasazhe, në të cilat Bibla qartazi thotë se Elohim (dmth Zoti-zotat sipas teologjisë hebreje) vdes, vdesin, siç vdesin të gjithë njerëzit.

- Ata ishin qenie, të cilat udhëtonin në makinat fluturuese, duke mbuluar hapësira, në një kohë të shkurtër të pamenduara për ata që kanë lëvizur në këmbë.
- Larg nga të qenit të menduar si perëndi, fillimisht ishin qenie, që rrespektoheshin dhe u nënshtroheshin vetëm për shkak të fuqisë së tyre të madhe, e garantuar edhe nga teknologjia në dispozicion të tyre. Ata ishin të frikshëm edhe për shkak të mizorisë së tyre, një tipar për të cilin Bibla është një dëshmi e pagabueshme.
- Nuk ishin të zënë me çështjet e fesë, në kuptimin modern të termit, me shpirtëroren, me jetën e përtejme ... Kishin si qëllim themelor përkufizimin e strukturave të pushtetit të shpërndara në territore të ndryshme, në të cilat pastaj u zhvilluan qytetërime të ndryshme.
- Ishin qenie, që i dinin të fshehtat e natyrës e të kozmosit, dhe ua mësonin vetëm më besnikëve e ndjekësve të tyre, duke i dhënë kështu mundësi fillimit të kastës së mbretërve, sundimtarëve, priftërinjve (Të ashtuquajturit "nisësit, filluesit" e njohurive, natyrisht ...).
- Yahweh (Zoti, simbas hebrejve), larg nga të qenit i vetmi dhe i gjithfuqishëm, ishte njëri prej tyre: njëri, të cilit i ishte besuar detyra, që të kontrollonte një territor të caktuar. Por në të vërtetë edhe për këtë nuk mund të jemi të sigurt. Ai gjithashtu mund të ketë pasur pavarësinë për t'i dhënë fuqinë e tij një territori, një popull që askush nuk ia kishte dhënë para atij (studimi vazhdon në këtë drejtim).
- Elohimët, "kanë krijuar" *Homo Sapiens* (ose ndoshta *sapiens sapiens*-njeriun e sotëm), nëpërmjet një ndërhyrjeje të inxhinierisë gjenetike, që teksti biblik i *Zanafillës* tregon duke theksuar përdorimin e dy llojeve të ADN që u interesonte: atë aliene dhe atë tokësore-Hominide (njerëzore). Hibridizimi gjenetik është kryer nga individë fizikisht të ngjashëm me ne, por me njohuri dhe teknologji pakrahasimisht sipërore: ata e kanë bërë në mënyrë që të prodhojnë një rracë punëtorësh-shërbyesish, që do të

dëshironin t'i përdornin për punët e tyre.

Dhe ndoshta kanë bërë shumë ndërhyrje të shpërndara nëpër kohë. Ndërhyrja në lidhje me Adamin dhe Evën mund të ketë qenë vetëm një nga *shumë ndërhyrjet*, sepse ata nuk janë të parët e njerëzimit, siç do të shohim në vazhdim.

Janë përpjekur gjithashtu, që të zhvillojnë kulturalisht këtë rracë të re hibride, (*homo sapiens*, ose ndoshta *sapiens sapiens*) nëpërmjet përhapjes së kontrolluar të njohurive:

teknologjike, civile, juridike, agronomike, astronomike, matematikore, bashkë-arkitektonike, letrare, politike etj., ..

- Bibla na tregon një shumëllojshmëri të individëve të dalluar në jetë qysh nga Adami, individë, që ishin të njohur me emra të ndryshëm dhe ishin grupuar në hierarki. Në varësi të roleve që kishin dhe llojit të trupit, janë të përcaktuar me emra të ndryshëm, të përgjithshëm e të përveçëm, nga ku do të përmendim disa: **Elohim, Nephilim, Refaim, Anaqim, Emin, Zamzummim**, (të njohur si gjigantët), **Malakim, Shedim, Baal, Baal-Zafon, Baal-Zebub, Milkom, Melkart, Nibaz, Tartan, Adrammelec, Anammelec**, ... si dhe individët e grupeve të njohura edhe nga kulturat e tjera me emrat e tyre përkatës: **Anunnaki, Igigi, Igigu, Dingir, Irsirra, Ilu, Ilanu**- tek sumerët dhe akkadianët. Po ashtu edhe: **Neteru, Shamsu-Hor për Egjiptianet; Viracochas (Virakokas), Quetzalcoatl**, të kulturës të mesit dhe të Jugut të Amerikës; **Asi, Tuata e Danann** për disa pjesë të Evropës Veriore dhe traditës gjermanike ... (Janë të gjithë emra, që me anën e gjuhës shqipe të sotme marrin kuptim të plotë. Shif : "Emnat ilir nëpër botë" S.Hushi).

- Bibla përçon me qartësi të madhe kujtimin e qenieve: nga shtatgjigantët me gjashtë gishtërinj në çdo gjymtyrë (esadattili) dhe flet me qetësinë më të madhe, duke rrëfyer se si ata luftuan në radhët e Filistejve, dhe përse ata ishin aq armiqësorë ndaj Yahweh (Zotit ebre) dhe njerëzve të tij.

- Të ashtuquajturat engjëjt, ishin individë prej mishi dhe

kockash, shpesh të rrezikshëm për t'u takuar. Ata kishin nevojë për të ngrënë, për të fjetur, për të pushuar, për t'u larë. Ata mundet që edhe të jenë sulmuar, prandaj duhej të mbroheshin; i përkisnin klasës së "të mëdhejve ndërmjetës" (njerëz të shejtë) të hierarkisë dhe shërbenin si lajmëtarë dhe vrojtues (astronomë, historianë etj). Me shumë mundësi u përkisnin popujve të: *Igigi, Igigu*, të kulturës sumero-akkadiane. Pra asgjë nuk ka të bëjë me njësi shpirtërore, për të cilat na tregohet në traditën fetare.

- Kerubinët biblikë, larg nga të qenit qenie engjëjlore, në të vërtetë ishin gjëra me paraqitje e funksione të ndryshme: Ata që përshkruhen nga Ezekieli ishin "*makina fluturuese*", që Dhiata e Vjetër i përshkruan shumë mirë në lëvizjen e tyre, si në mënyrë të pavarura ashtu dhe me mjetet e transportit të Yahweh- Zotit ebre[kavod, Ruach, Merkavah];
- Kerubinët e Arkës së Besëlidhjes (Arkës së Aleancës), në të vërtetë ishin përbërës, që i përkisnin një sistemi të komunikimit me radio, të cilët gjithashtu përdornin vegla të transportueshme, të tilla si [efodi]. Sipas disa gjuhtarëve hebrej, që i marrin të dhënat nga letërsia Talmudike, thuhet se ata ishin (ose kthehen) në robotë e janë përdorur për të mbrojtur Arkën e Besëlidhjes, si dhe përmbajtjen e saj të vlefshme dhe të rrezikshme. Por për këtë nuk kemi asnjë gjurmë në Bibël dhe prandaj do marrim parasysh të dhënat e Kodit të Masoretëve, me të cilat po punojmë.
- Arka e Besëlidhjes ishte në atë kohë një mjet i zhvilluar teknologjik me përdorime të shumta.

Përfundimet e para të shkurtëra

Të gjitha këto çështje janë ende nën analizë dhe të tjera janë rrokur në libër. Nuk është rastësi, që kemi zgjedhur për t'i kushtuar atyre tre kapitujt e fundit të kësaj pune si dhe dy ngjarjeve themelore të përshkruara në kapitullin e parë të librit të parë të Dhiatës së Vjetër: "formimin" e njeriut dhe "jo-krijim" të universit.

Last but not least: (E fundit, por jo më pak e rëndësishme): është menduar se natyra konkrete shkencore dhe teknike mahnitëse e këtyre dy operacione të kryera nga Elohim meritojnë një vëmendje të veçantë.

Në përfundim të kapitullit “1”, i cili ende vepron si bazament, mund të themi se historia e njerëzimit duhet gërshetuar dhe kushtëzuar nga mundësia e takimeve të vazhdueshme me qytetërimi më të zhvilluara, nga ai i planetit tonë, që përdorën të gjitha njohuritë, në mënyrë që të arrinin qëllimet e tyre plotësisht materiale.

2

El me emrin Yahweh (Zoti hebre) dhe mjete i transportit

Përkundrejt këtij sfondi, shtrojmë pyetjen: me çfarë gjëje zhvendoseshin Elohim? Në Dhiatën e Vjetër përmendet “qerre” e Yahweh(Zotit) dhe përshkruajnë karakteristikat e saj në forma të ndryshme: Mënyrën me të cilën ajo paraqitet dhe lëviz, efektet e jashtme të prodhuara nga lëvizja e saj dhe përshkrime të tjera të detajuara ...

(Nëse i ndaj simbas shpjegimit të librit tim: “Emnat ilir nëpër botë”, këto fjalë i kuptoj si: Elohim=ilahim; Elohim=elohim=ylli im. Yahweh=yave=yabe=y asht be=yll asht ba=Ylli asht bej=ylli asht Zot. Besoj se qysh në fillim, gjuha shqipe e zgjidh enigmën yllore të këtyre personazheve. S.Hushi).

Shprehjet e përdorura nga autorë të ndryshëm biblikë, sidomos në varësi të parqitjes, që në çdo kusht e në çdo qoshe dhe gjendje të veçantë, që ata duan të evidentojnë, në thelb janë si më poshtë:

1. [Kavod].
2. (Ruach, ruak).
3. (Rechev, Rekev, Merkavah).

Le të shikojmë kuptimin e zanafillës:

1. **KVD** [Kaved, kavod]: këto rrënjë bashkëtingëlloresh, para së gjithash, janë bartëse të konceptit të "peshës, të masës, të forcës," si dhe të "lavdisë, nderit" Shif: (*Is 21,15; Isaia 32,2; Pr 27,3; Pr.18.21; Eksodi 24, 15-17; Esodi 33,18; Es 43.4;*).
- Për thjeshtësi leximi nga ana e lexuesve, që nuk janë në dijeni të rregullave gramatikore, zgjodhëm **kvd**, për të risjellë tekstin aktual, që duke i shtuar zanoret përkatëse bëhet: kavod (gjendje absolute). Edhe në rastet kur format në referimet përfshin leximin si: [kevod]=(gjendje e bërë, diçka e ndërtuar, të cilën e kemi përdorur në punën tonë, sepse është gjerësisht e pranishme në tekstin biblik. (Ke-bo-di=Ke bo dituri=Kah esht bo ditunia=Është krijuar dituria. S.H).*
- Asgjë nuk ndryshon kursin e analizës, që ne po kryejmë.*
- Në veçanti, *Rav Matityahu Clark*, në fjalorin e tij të etimologjisë-6, , rrënjëve të bashkëtingëlloreve gojore **wgh** i mvësh kuptimin "weigh", që do të thotë "peshojnë", kanë peshë." Mbiemri përcaktues [Kaved, kavod], përcakton atë që është "e rëndë, e vështirë, e mundimshme, e rëndësishme, e nderuar", por edhe "e mpirë, e ngathët, zemërgur". Si emër do të thotë "forcë" por edhe "mëlçia". Kështuqë [kavod] do të thotë "pesha, masa, nderi, respekti, lavdia, shkëlqimi, pasuria, mëlçia."
- Do i rikthehemi përsëri; për tashti theksojnë se, në ballë të këtyre kuptimeve të ndryshme, autorët (priftat S.H) grekë (*Bibla e LXX*) e kanë përkthyer këtë term me fjalën "Doxa", e cila nga ana tjetër është zëvendësuar në gjuhët moderne me fjalën "gloria=lavdia". Përkthimi i kësaj fjale ka qenë gjithmonë i ndikuar nga pikëpamja tradicionale e hyjnore, por që nuk përputhet me përfaqësimin e Elohim (Perëndisë ebreje) në Dhiatën e Vjetër, sepse në fakt çdo gjë mund të ish, përveçse qenie shpirtërore **JO**. Fantazia e çuditshtshme fetare ka ndryshuar e përmbysur plotësisht kuptimin e termit, për të bërë përfaqësimin shpirtëror, ose një mënyrë të veçantë, atë të çfaqjes së "Zotit": kjo ndryshueshmëri e kuptimit rrjedh natyrshëm nga nevoja që

ndjenë teologët (theologët-thënësit, studiuesit e feve) për të gjetur një mënyrë për të pajtuar termin [kavod] me idenë e Zotit, që ata e kanë përpunuar artificialisht. Duke punuar për zgjerimin e kuptimit si qenie e fuqishme, do të thotë gjithashtu: person i pasur, njeri me "peshë", që nderohet Por nuk duhet të mendojmë se shpirtërorja është punë vetëm e fetarëve të krishterë. Kemi të drejtë të hamendëojmë se e njëjta traditë hebraike, e përfaqësuar në fund nga masoretët, ka vepruar duke bërë një transferim të kuptimit nga peshë fizike, në atë metaforike, që të çon në konceptin abstrakt të rrespektit dhe të lavdisë. Kjo zgjedhje u diktua nga dëshira për ta shejtëruar përmbajtjen e librit dhe zëvendësimin me pamjen e feve, që besojnë në një Zot, që në fakt nuk i përkasin tekstit origjinal.

Pra, ajo që ishte "*e rëndë*" bëhet "*e lavdishme*" nëpërmjet një rruge të ndikuar nga format e mendimit, që ndoshta nuk pëputhen me synimet e vërteta të autorëve biblike. Me fjalë të tjera, kuptimet e "peshës" dhe "nderit" janë shpjeguar si shëmbëlltyrat Zotit si një thelb, si një bërthamë shpirtërore, në mes gjendjes së gjithfuqishme dhe të mbrendshme, i aftë të bëhet i kudondodhur kur zgjedh të çfaqet në një popull besimtarësh.

[Kavod] sumero-akkadik.

Rikthejmë këtu sintezën e një studimi ⁷, që ishte dërguar më parë nga studiuesi *Alexander Demontis*, punimet e të cilit janë të thëna në bibliografi. Autori shkruan se [kabod, kebod] në fund të fjalorit të ebreut biblik *Strong* janë shënuar me kod identiteti nr: 3518/3519 dhe të përcaktuar: [Kabod], që përkufizohet "i shpejtë, i lavdishëm". Nga fjala (kabad), termi i jep zanfillën fjalës (kabod) që don të thotë: "peshë, me peshë", ashtu si edhe me kuptimin: "i nderuar, i lavdishëm".

(-Simbas mendimit tim, studiuesit e ndryshëm, kur i mbushin bashkëtingëlloret me zanoret, që u mungojnë, duhet t'u shtojnë edhe zanoret në fund të fjalëve, të cilat bëhen:

Kabada, Kabadi, ose: Kabeda, Kabedi, ose: kaboda, kabodi, plotësisht me kuptim, nëse ndahen me fjalë njërrakshe: Ka-bo-di=ka bërë (ka bo) dituni. Dij gjithashtu se folja "KA dhe BA" janë shumë të vjetra, qysh nga koha e Atlantidës, po me atë kuptim, që kanë patur në lashtësi kanë dhe sot në shqip: me pas e me ba, me barë, me bërë. S.Hushi).

Pra, në gjuhën hebraike biblike, në bazë të fjalorëve me shumë autoritet të lëndës, (kabad) është termi, që i jep zanafillë fjalës tjetër (kabod), që kuptohet si: "peshë, me peshë, të rëndë" e që kuptohet edhe si: "i lavdishëm, i nderuar".

Koncepti është, se në qoftë se një person është i nderuar, apo ka peshë mbi të tjerët, është edhe "i rëndë".

A është me të vërtetë kështu?

Çelësi i kësaj zgjidhjeje është në drejtim krejtësisht të ndryshëm: duke qenë se ngjarjet biblike kanë ndodhur në një periudhë kohore shumë shekuj para krijimit të gjuhës hebraike, këto fjalë hebraike të përdorura në Torah, **janë transportim i termave më të vjetra (pellazge S.H).**

Në fjalorin e gjuhës Akkadiane, gjenden pika të përbashkëta në ekzistencën e termit "Kabatu". Fjalori akkadik zyrtar i "Association Assrophile de Francë" risjell:

- Në akkadisht: KABATU (ndryshe: KABADU).
- Në proto-semite: KABAD.
- Në ebraisht: KABAD

dhe me të njëjtën vlerë në karakteret hebreje, të cilët i risjell këtu si krahasim:

• Proto-Semitic : *kabād

• Hebrew : kābad כָּבַד

• Ugaritic : kbd 𐎧 𐎢 𐎢𐎢

Original Word: 𐎧𐎢𐎢𐎠

Transliteration: kabad or kabed

Phonetic Spelling: (kaw-bad')

Short Definition: honored

Siç shihet këtu lart, në fund arijmë në përfundimin që fjala kuptohet: I nderuar.

Por çfarë është KABATU në Akkadisht?


Lista e kuptimeve është çuditërisht e njëjlojtë me atë të [kabad]- [kabod] në ebraishte:

KABATU: që bëhet e rëndë, që bëhet e vështirë, e besdisëshme, me dhimbje, që bëhet i rëndësishëm, i nderuar, i mbipeshë (tejkalon peshën maksimale), mbizotërues; pët t'u bërë i rëndë, që meriton rrespekt, i nderuar, që e tepron, të jetë i nderuar – me e nderuar, me e kënaqur, etj.

Gjëja që të habit është se referenca ndaj peshës është përdorur shumë gjatë në përcaktimin e këtij termi, i cili do të thotë edhe si përdorimi i kuptimit "i nderuar, i lavdishëm" ashtu edhe si: "me pasur peshë, duke u bërë i rëndë", dhe jo e kundërta, ashtu siç duket të jetë treguar nga gjuha ebraike. Kuptimi i kësaj është jashtëzakonisht i rëndësishëm, sepse është një dëshmi pasardhëse e një tjetër koncepti thelbësor për analizën e teksteve të së kaluarës. Dorë mbas dore që ecet përpara në kohë, në rrjedhat e gjuhëve të tjera, kuptimet e fillesës materializohen në zanafillën e veçantë dhe përthithin të përgjithëshmen e të përhapurën. Kështuqë, sa më shumë që kalon koha, aq më shumë gjenden kuptime të përhapura, të lindura nga përdorimet dhe interpretimet e ndryshme të

materialeve të zanafillës. Nëse kjo është e vërtetë, duhet të ketë ekzistuar një term **më paraardhës nga ai akkadik**, (pellazg S.H), që shërbeu si një burim, tek i cili kuptimet duhet të kenë qenë më pak figurative.

E pra, fjalorët akkadianë thonë se "Kabatu" në gjuhën sumeriane, bëhet "DUGUD." Për sumeret DUGUD në formën origjinale kuneiforme bëhet:

[DUGUD : ]

Libri "*Sumerian Lexicon*" i John Halloran (më 2003) thotë:

dugud : n., weight; cloud [DUGUD archaic frequency: 2].

adj., massive; heavy; difficult, hard (du-, 'complete', + gud, 'bull').

Që ka kuptimet: Pesha, retë, masivet, të rënda, vështirësi, të fortë, të vështirë.

Gjurma etimologjike është, sipas Halloran, tek bashkimi i rrokjes DU = "i plotë" me = gud + = "kau, buall". Siç mund të shohim, **të gjitha kuptimet janë të ribëra nga karakteristikat e vërteta:** nga pesha dhe ngurtësia, nga fortësia e diçkaje.

Por le të kërkojmë në fjalorë të tjerë.

Fjalori Sumerian *Glossary* i Daniel Foxvog (botuar me 2009) raporton:


dugud v. & adj. (to be) heavy, huge, weighty, important

Edhe një herë, jepet kuptimi: "të jetë i rëndë, i madh", që shkon drejt kuptimit: "të rëndësishëm".

Për **lavdinë** nuk flitet as këtu.

Nuk mbaron këtu, sepse është diçka edhe më e çuditshme. Në vitin 1908, sumerologu John D. Price, profesor i gjuhëve semite në Universitetin e Columbias, gjurmon etimologjinë e fjalës "rënduar=DUGUD" nga gjuha sumeriane, duke e

bërë të rrjedhë nga bashkimi i rrokjeve, që janë të përkthyer "Nata" + " me qenë e zezë." Ndryshe nga çfarë do të bëjë me dhjetra vjet më pas *Halloran*, ai e identifikon termin me një zgjatje të "zhytet natës" (term i përdorur në gjuhën angleze, që ai e bën shumë më mirë se sa në italiasht: "poshtë-fundosja Night"), nga të cilat ajo tërheq kuptimin e "të jenë të rënda" dhe lidh atë deri në KAB Akkadian është parë tashmë (A) TU = "rëndë." (Sipas meje At-u=me pleqsi usht=Zoti është. Në të folurën e përditshme, për një të ditur thuhet se ka peshë, është i rëndë. Nëse DUGUD=Dugut=du=g=ut=dhanë gjiri atit, Zotit, S. Hushi). Pra, duke iu afruar origjinalit sumerian, shofim se si nga gjuha akkadike, rrodhi hebraishtja.



Kështu kemi tre përfundime të termit, që njohin atributet e peshës, e jo të lavdisë dhe në rastin e vetëm në të cilin kjo peshë shihet si një përshtatje e vetvetes (rasti i Princit). Kjo zgjatje nuk vjen nga një ide e "madhështisë apo rëndësisë", por nga diçka që "peshon" në atë ditë.

Duke falenderuar mikun studiues për tekstin e dërguar dhe për autorizimin në përdorimin e saj, vërejmë se kjo analizë kaq e dokumentuar, e kryer në gjuhët sumeriane dhe akkadiane, dokumenton atë, se si kuptimi i parë i formave shprehëse, që kanë pasur tekstet biblike, kishte atë formë shprehjeje që i parapriu tekstit biblik, atë vlerë absolutisht konkrete që kemi filluar të grumbullojmë në këtë faqe dhe që do ta kuptojmë më mirë në vazhdim si: Peshë fizike, peshë materiale, (edhe peshë mendore. S.H).

Për hir të plotësimin të njohurive, risjellim rrejtët ebraike me zanoret dhe kuptimet, që gjenden në "Fjalorin e ebraishtes dhe aramaikes së Biblës" së *Shoqërisë Biblike Britanike*.

- [KAVED] (si një folje): të jetë e rëndë, që peshojnë, të jetë i nderuar, të jenë të fortë, të jenë të pandjeshëm.
- [KAVED I] (si një mbiemër): i-e rëndë, i- vështirë, i rëndësishëm, i pandjeshëm, i ngathët, i pasur.
- [KAVED II] (si emër):, mëlçia, forca.
- [koved] (si emër): pesha, turma-shumica.
- [kavod] (si emër): pesha, masa, nderi, respekti, lavdia , shkëlqimi.

Përtej analizës së pastër gjuhësore, që përcakton diskutimin e ashpër shekullor laik, pa shtuar kurrë përfundimet e pranuar, është ndërthurja e elementit të vërtetë, që ndihmon për të sqaruar dhe kuptuar të gjithë. Ne do ta shqyrtojmë atë me hollësi më vonë.

2. [Ruach]: tregon "erë", "fryma", "frymëmarrje" lëvizje të ajrit, stuhi ere. *[Në shqip bëhet: Ra-aç, Ro-aç, Reaç=Ra(ga qielli)-aç, Ro(rron) aç, re-aç dhe ka shumë krijime të bukura fjalësh. Nëse marrim parasysh që leximet pellazge bëheshin nga e djathta në të majtë, fjala "re" mund të lexohet edhe "er"=fllad, ajër, frymë, fryma e shejtë. Çdo analizë fjale, që bëhet këtu më bind që janë me bazament pellazgo- shqiptar. S. Hushi].* Në përpunimet e stërholluara fetaro-shpirtërore, ka marrë kuptimin e "shpirtit" (fryma e shejtë) në kuptimin, që të gjithë njohim një vlerë, që fillimisht ndoshta nuk i përkiste (1 Re 18,11-12; 2 Sam 22,11; Ez 8,3; Ez 43.5). Siç është vërtetuar për [kavod], edhe ky term ka pësuar një ndryshim, një thithje të njëpasnjëshme të kuptimeve, që dilnin nga shtrirja, dhe që e çoi atë drejt kuptimit të "shpirtit", që, siç do të shohim, shqyrtimi i ndërthurjeve të ndryshme na ndihmon për të njohur vlerën e saj origjinale, shumë saktë e në shumë raste.

Termi ka disa kuptime, të gjithë të ligjshëm, që mund të jenë përpunuar kohë mbas kohe me ndihmën e ndërthurjeve, siç do ta shohim më vonë. Do të thellohem në analizën e kësaj veçantie, por për tashti të ndalemi këtu mbi një element: **termi [Ruach] ka origjinë shumë më të**

vjetër se ajo hebreje. Rrënjët e saj janë shumë thellë në kulturën sumeriane-akkadiane, në të cilën tingëllima e fjalës "Rua" bëhej me një piktogramë shumë të qartë dhe të efektshme në qartësinë e saj. 9.




Figura 1. (Vizatim i dokumentuar edhe në: Zanafilla alternative, www.goldenageproject.org.uk).

(Edhe pamja e kësaj figure dhe fjalës: reaç=re aç, kupohen menjëherë në shqip, sepse shifet si një re sipër ujit, apo si një disk fluturues, që nxirrte një re tymi e shërbente si udhërrëfyes për popullin, që po kalonte nëpër shkretëtirë, S. Hushi).

Për hir të plotësisimit të njohurive, mund të themi se disa e konsiderojnë këtë vizatim me origjinë fenikase, por edhe kultura fenikase, që si në të gjithë Lindjen e Mesme, duke përfshirë edhe atë hebreje, i ka rrënjët e veta në atë zonë, që ka qenë e mvarur nga civilizimi sumerian (pellazg S.H). Dijetari i përmendur më lart vëren se vizatimi përmban dy pjesë të ndara: një objekt me formë të saktë dhe të caktuar (mund të jetë i mundur - por i pasigurtë = tingulli "RU"), i cili është e vendosur mbi një masë e ujit poshtë saj (mendoj se : "R" bashkohet me të gjitha zanoret= Ra=re=ri=ro= ru, plotësisht me kuptim me shqipen e sotme, S.H). Elementi lart qëndron mbi pjesën e poshtme pa e prekur atë; duke mos dashur të veprojmë me hamendësime e të mos themi

me siguri të plotë, se për çfarë gjëje trajtohet, përdorim shkurtimet, që i kemi marrë hua nga "*Lexicon recentis latinitatis*" -fjalori i gjuhës latine, i botuar nga Libraria Editrice e Vatikanit dhe e quajmë R.I.V, dmth "*Res Inexplicata Volans*" (që përkthehet: "objekt i fluturues i paidentifikuar ", në anglisht: "*Unidentified Flying Object=UFO*").

Për këtë mund të jemi të sigurt sepse: kjo "gjë e paidentifikuar mirë" është pezull mbi një hapsirë me ujë. Ky i *Kristian O'Brien* është një interpretim që, për pranimin e tij, vetëm nga pikëpamja filologjike mund të ndikohen sigurisht nga pasiguritë e pashmangshme, që dalin nga njohuritë e paplota ndaj gjuhës kuneiforme dhe përfaqësimeve të saj piktografike, (si hieroglifet, S.Hushi.) Kur kemi të bëjmë me gjuhët e lashta, gabimet janë gjithmonë të mundura me një probabilitet shumë të lartë statistikor. Mjafton të shqyrtojmë ndryshimet e përkthimeve, që takojmë midis dijetarëve dhe akademikëve me emër, për të kuptuar që, si e vetmja mënyrë e drejtë është, që të vazhdojmë me hamendësimet.

Ky çelës i të lexuarit mund të ngjallë dyshime, kështu që më përpara do t'i japim vlerë edhe shpjegimeve të tjera interesante. Duke pasur parasysh rrezikun e pasaktësisë, që karakterizon temën, tashti për tashti, siç po bëjmë, po përpiqemi për të vazhduar në domethënie e parë duke shoshitur ndërthurjet, si ato që mund të përcaktojmë si përgjithësisht më të lashta nga ato biblike.

Me këtë dritë do të shohim provat më poshtë se si përfaqësimi ikonografik, kur shikohet në mënyrë paralele me tregimet është i habitshëm , sepse së pari futet [Ruach] në historinë biblike.

Që nga titulli, shumë kurioz, vërejmë sërish se në *Lexicon* të përmendur, Vatikani ka shtuar terma të tjerë, që i përgjigjen një mjedisi hapësinor: *aelia navis*, *navis sideralis*, *aelius viator*, përkatësisht "anie ajrore", "anie kozmike"

dhe "pilot". Dallim jo i pakët, nëse kemi parasysh lidhjen me interesin, që shteti i Vatikanit tregon për argumentin, duke investuar të holla, njerëz dhe kohë në observatorë kozmike dhe në konferenca kushtuar kërkimit dhe studimit të mundësisë së jetës aliene.

Po të parafrazojmë *Heraklitin (Heraclito, Heraclitus)*, mund të themi se vetëm duke qenë të gatshëm të pranojmë të papriturën, mund të lëvizim drejt një të vërtete të papritur, që është domosdoshmërisht e mjegullt e jo në atë, që tashmë e dijmë.

Nëse hamendësojmë, që jemi duke provuar se si zbulimet e pa baza shuhen, fshihen, ndihmohemi për të nxitur kërkime, (verifikime), përballë linjave të ndryshme të mendimit: në të gjitha qëndrimet e nevojshme për tejkalimin e ngrirjes së dogmatizmit, që përsërisin të njëjtën gjë për shekuj me radhë.

Mendojmë se megjithatë, këto hamendësime kanë arsye të dobishme, që të mbeten të vlefshme për një kohë të gjatë.

3. [*Rechev*], [*merkavah*]: Tregon pikërisht një karro, një mjet lëvizës, që kuptohet si një mjet për mbartjen dhe lëvizjen e njerëzve dhe mallrave (*Gen 41,43; Ex 14,25; 1Re5.6; 2Re23,11; Zakaria 6,1 ...*).

Në ndryshim me atë që është vërtetuar për [*kavod*] dhe për [*ruach*], përkthimi i fjalës nuk ka paraqitur probleme të veçanta gjuhësore. Vërejmë se kjo fjalë ka një përdorim të lidhur me qerren e Zotit -Yahweh, dhe është përdorur edhe në shumës, kur flet për qerre, karro, në lidhje me çfaqjen e Zotit (Elohim).

Normalisht, qerrja e luftës, shumë shpesh vlerësohet me fjalën-rrënjë [*rachav*], që tregon gjëndjen e të ngjiturit në kalë: do të shohim se ky mendim është praktik dhe realist në rastin e kerubinëve të Ezekielit.

Në përmbledhje ...

Në mënyrë të përmbledhur mund të themi se termat e studiuara, [*kavod*], [*ruach*] dhe [*merkavah*], na japin të

dhëna, që në të gjithë bashkësinë na njeh me një mjet jo shumë të njohur, (*R.I.V, Res Inexplicata Volans*) që:

- është masiv dhe i rëndë (i lavdishëm).
- udhëton nëpër ajër si një lloj ere;
- është përdorur për transportim.

Shembuj të UFO-(R.I.V.) në veprim tek Bibla.

Përtej të gjithë përpunimit, stërholimit gjuhësor, është tejkaluar analiza e pastër gjuhësore, që shpesh nuk të çon në kuptime të caktuara qartë e të pakundërshtueshme, prandaj le të shohim disa shembuj të UFO=R.I.V.- it Biblik në veprim, ashtu siç edhe është përfaqësuar në paragrafë të shumtë.

Përshkrimi i asaj që bën, i përdorimit që bën, nga pasojat pak të pëlqyeshme që prodhon, ose më mirë, vrojtimi i veprimit të tij në hapësirë dhe ndërveprimi me njerëz është patjetër më i dobishëm dhe efektiv se sa çdo vlerësim tjetër. Po qartësojmë kështu idenë duke qëndruar në ballë të dëshmisë së këtij "objekti të paidentifikuar" në lëvizje. Rimarrim kështu rrënjët hebraike, që i përmbahen atij dhe shohim dukuritë biblike në të cilat janë përshkruar "operacionet", veprimet e tij si dhe pasojat që shkakton.

1) Rrënjët **KWD**, [Kaved, kavod].

Eksodi 33,7 etj.

Pas largimit nga Egjipti, autori i librit, i cili tradicionalisht thotë se është vetë Moisiu e i njëjti Mose-Musa, na informon "faktin" se Zoti-Yahweh drejtonte personalisht e fizikisht popullin në vazhden e të gjithë endjes në territorin e Sinait. Moisiu, në çdo etapë përdorte çadrën, që elohimi Yahweh e kishte ndërtuar dhe e vendoste jashtë kampit.

...VAZHDON...